



15-02-2019

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:064152
Datë: 10.01.2019
Numri i dokumentit: 00203522

P.nr.2012/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me procesmbajtësen-praktikante Marigona Shaqiri në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED], për shkak të veprës penale Mospërfillja e Gjykatës nga neni 401 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1250-7/17 të datës 15.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të prokurorit të shtetit Mimoza Syla Hyseni, të akuzuarit me 20.12.2018, shpall dhe publikisht komunikon, ndërsa përpilimi me shkrim i këtij aktgjykimi u bë më datë 10.01.2019, ku mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, i lindur me [REDACTED] ne fshatin [REDACTED], Komuna Shtërpçë, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], i martuar, baba i shtatë fëmijëve, bujk, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mire ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Është fajtorë

Se me dt.05.07.2017, rreth orës 13:00, ne rrugën "██████████" ne Ferizaj, edhe pse ka qene ne dijeni se është e ndaluar qe te hyj ne pronën kontestuese me familjen ██████████, meqë ka ekzistuar vendimi i plotfuqishëm i Gjykatës Themelore ne Ferizaj me numër E.nr.1553/08 i datës 27.05.2013, i njëjti ditën kritike hyn ne atë prone dhe fillon te punoj duke kositur barin,-

me të cilën ka kryer veprën penale Mospërfillja e Gjykatës nga neni 401 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne baze të neneve 4,7,17,23,41,51 dhe 73 të KPRK-së si dhe neni 365 të KPPK-së, shqipton:

Dënim me kusht

Të akuzuarit i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 /tre/muaj/ i cili dënim nuk do te ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda 1/një/viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale (koha e verifikimit).

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit prej 25 (njëzet e pesë) €, dhe për viktimat e krimit prej 30 (tridhjetë) €, në afat prej 30 ditësh.

I dëmtuari ██████████ nga Ferizaj rr. '██████████' për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/II.nr.1250-7/17 të datës 15.08.2017, ka akuzuar [REDAKTUAR] për veprën penale Mospërfillja e Gjykatës nga neni 401 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 20.12.2018, në të cilën shqyrtim i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendim real dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, i premtonte gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, duke shtuar se kemi një kontest civil dhe do ta presim vendimin e Gjykatës se Apelit, i ka propozuar gjykatës që të shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: Aktgjykimi i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj me numër P.nr.1522/15, i dt.07.03.2017, aktvendimi i lëshuar nga Gjykata Themelore Ferizaj me numër E.nr.1553/08, i dt.26.07.2016, si dhe fotografitë dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Mospërfillja e Gjykatës nga neni 401 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, baba i 7 fëmijëve, përkatësisht mbajtës i familjes, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ka

ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës dhe me dënimin e shqiptuar me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 458 dhe 459 të KPPK-së dëmtuarin [REDAKTUAR] nga Ferizaj rr. [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzetë e pesë/ € si dhe për viktimat e krimit shumën prej 30 /tridhjetë /€, në afat prej 30 ditësh.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2012/17 me datë 10.01.2019

Procesmbajtëse
Marigona Shaqiri

Gjyqtarja,
Hakile ILAZI



Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15/pesëmbëdhjetë/ditësh. Kurse i dëmtuari mund të paraqes ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.